

## **Suela Prençi**

Mban pozicionin e Këshilltarit në Njësinë e Shërbimeve të Përgjithshme Ligjore, në Departamentin e Shërbimeve Ligjore, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga muaji Mars i vitit 2020.

Është diplomuar me titullin “Jurist” në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës në vitin 2001. Ka përfunduar, programin e studimeve “Master Profesional për të Drejtën Penale” në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës në vitin 2018. Ka marrë titullin “Avokat” pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë në vitin 2002.

Gjatë periudhës kohore Tetor 2013 deri në Mars 2020, ka kryer funksionin e Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimit, në Prokurorinë e Përgjithshme, ndërsa prej Janarit 2007 deri në Shtator 2013, ka kryer funksionin e Juristit të prokurimit, në Prokurorinë e Përgjithshme. Në Mars 2004 deri në Janar 2007, ka kryer funksionin e sekretar – operatorës në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.

Në vitin 2013 është çertifikuar si “Trajner për Prokurimin Publik” nga International Training Centre në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, në kuadër të Projektit të BE “Trajnim për Prokurimin Publik në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi”. Gjithashtu, në vitin 2007 është çertifikuar si “Trajner Trajnerësh për Oficerët e Prokurimit Publik”, nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Marrëveshja e Prag - Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë.

Prej vitit 2016 është angazhuar si trajnere e jashtme në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), në Agjencinë e Prokurimit Publik, si dhe në projekte të asistencës ndërkombëtare si, USAID, OSCE, etj.

Ka marrë pjesë në shumë seminare dhe trajnime të ndryshme, të lidhura me eksperiencat e punëve që ka kryer.